



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi*, Trupi Gjyqësor, më 4 tetor, miratoi kërkesën e tre të afërmeve të viktimës pjesëmarrëse që ka ndërruar jetë, të marrin pjesë në proces në emër të tij. Me këtë vendim, numri i gjithsejtë i viktimave pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore arrin në 143.

Më 3 tetor, Trupi Gjyqësor hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit dhe Mbrojtjes së Selimit për shtyrjen e dëshmive të tre dëshmitarëve deri në bllokun e ardhshëm të dëshmive.

ZPS-ja kishte njoftuar palët më 15 shtator, se ekziston mundësia që ajo të thërrasë tre dëshmitarë si dëshmitarë rezervë gjatë bllokut të dëshmive në tetor. Meqë emrat e dëshmitarëve nuk ishin në listën e 40 dëshmitarëve të parë, Mbrojtja kërkoi të shtyhet dhënia e dëshmisë së tyre, me argumentin se nuk do të ketë mjaftueshëm kohë për t'u përgatitur për marrje në pyetje nga pala tjetër.

Trupi Gjyqësor rikujtoi se dëshmitarët janë "dëshmitarë rezervë" të cilët mund të thirren, apo të mos thirren në tetor, varësisht nga vlerësimet reale të palëve lidhur me kohëzgjatjen e dëshmive të dëshmitarëve. Gjithashtu, Trupi Gjyqësor konstatoi se Mbrojtja u njoftua më 15 shtator për mundësinë e dhënies së dëshmisë nga këta dëshmitarë, që është të paktën 3 javë para fillimit të bllokut të dëshmive në tetor. Trupi Gjyqësor rikujtoi gjithashtu se, për shkak të llojit të këtyre dëshmitarëve, duhet të ekzistojë një shkallë fleksibiliteti lidhur me radhitjen e paraqitjes së dëshmitarëve rezervë.

Për këtë arsye, Trupi Gjyqësor bindet se Mbrojtja është njoftuar mjaftueshëm në kohë dhe do të ketë mjaftueshëm kohë për t'u përgatitur si duhet për dëshmitë e mundshme të dëshmitarëve dhe hodhi poshtë kërkesën e tyre lidhur me shtyrjen e dhënies së dëshmive.

Më 3 tetor, Trupi Gjyqësor miratoi pjesërisht kërkesën e ZPS-së lidhur me pranimin si prova të dokumenteve të caktuara që nuk kanë të bëjnë me dëshmi të një dëshmitari dhe që janë sekuestruar në vendbanimet e z. Krasniqi dhe z. Selimi. Dokumentet në fjalë përfshijnë komunikata të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, deklarata politike dhe kumtesa të tjera; deklarata publike të UÇK-së, deklarata publike jopërfundimtare të UÇK-së konfiskuar z. Krasniqi; arkivin e botuar të agjencisë së lajmeve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së "Radio Kosova e Lirë"; arkivin e botuar të agjencisë së lajmeve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së "Kosovapress"; dhe ribotime në media të tjera të materialit të "Kosovapress" si dhe disa dokumente të tjera.

Trupi Gjyqësor theksoi se fakti që njëri prej qëllimeve të komunikatave të UÇK-së mund të ketë qenë për të shërbyer si propagandë dhe se përmbajtja e disa prej tyre për këtë arsye përbëhet prej pretendimeve të fryra, nuk i bën ato të papranueshme. Trupi Gjyqësor do të vendosë se çfarë synohej të arrihej me to.





Të enjten, 28 shtator, Trupi Gjykes dha arsyetim me shkrim lidhur me një vendim gojor të mëparshëm për pranimin si prova të deklaratave të një dëshmitari, dhe e hodhi poshtë si të tejkaluar kërkesën e Mbrojtjes për rishikim të vendimit gojor.

ZPS-ja kishte kërkuar që të pranohen si prova deklaratat e dëshmitarit të dhëna Prokurorisë Speciale të Kosovës dhe ZPS-së, sepse dëshmia e dëshmitarit para DHSK-së ishte e mjegullt dhe dëshmitari tha se nuk ishte në gjendje të kujtonte asnjë hollësi. Trupi Gjykes mori parasysh mbështetshmërinë e deklaratave të mëparshme, si dhe faktin që dëshmia e dëshmitarit përmban prova lidhur me një incident të përmendur në aktakuzën e konfirmuar, përfshirë material potencialisht inkriminues lidhur me përgjegjësinë penale individuale të z. Thaçi dhe z. Selimi. Trupi Gjykes u bind se drejtësia e përgjithshme mund të ruhet, përkundër pranimit të kësaj prove dhe se ky veprim është në interes të drejtësisë.

Në arsyetimin e Trupit Gjykes u tha gjithashtu se Mbrojtja pati mundësinë të marrë në pyetje dëshmitarin, dëshmitari është në grupin e pesë dëshmitarëve të cilët dëshmojnë për të njëjtin incident, dhe se Mbrojtja do të ketë mundësinë të thërrasë dëshmitarët e vet dhe të ofrojë dëshmi përkatëse në lidhje me këtë incident. Trupi Gjykes është ai që do të vendosë se çfarë peshe, nëse kanë, do t'u kushtohet këtyre dëshmime.

Të gjitha vendimet mund t'i gjeni në faqen e internetit të DHSK-së.

Seanca vijuese në këtë çështje gjyqësore është planifikuar për të hënë, 9 tetor, në orën 9:00 paradite.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, Trupi Gjykes më 29 shtator bëri të ditur Vendimin e 6 shtatorit, në të cilin miratoi kërkesat e Prokurorit të Specializuar dhe të Mbrojtjes për pranimin si prova të disa materialeve lidhur me dëshmitë dhe raportet e tre dëshmitarëve ekspertë të cilët dëshmuan gjatë gjykimit.

Gjykimi në çështjen *Pjetër Shala* rifilloi të hënë, 2 tetor, me dëshminë e z. Bedri Dervishaj, i cili është dëshmitari i dytë i thirrur nga Mbrojtja. Të martën, 3 tetor, dëshmitari i tretë, z. Naser Koçinaj, filloi dhënien e dëshmisë. Të dy dëshmitarët dëshmuan pa masa mbrojtëse dhe u morën në pyetje nga Mbrojtja dhe Prokuroria. Trupi Gjykes gjithashtu bëri disa pyetje. Sipas dëshmimeve të tyre, dy dëshmitarët pretendohet se ishin anëtarë të UÇK-së të cilët shërbenin në Kukës, Shqipërinë veriore, gjatë kuadrit kohor të përmendur në aktakuzën e konfirmuar.

Seanca vijuese në këtë çështje gjyqësore është planifikuar për 23 tetor në orën 9:30 paradite.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

